



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 2 Korrik 2013, në orën 9:00, Salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Mentor Shala, drejtor i përgjithshëm i RTK-së dhe Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 19.6.2013**
3. **Shqyrtimi i raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012;**
4. **Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës ;

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 19.6.2013;

Kryetari, konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 19.6.2013.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2012;

Kryetari – Në vitin 2011, ZAP-i ka nxjerr 9 rekomandime, të cilat për komisionin kanë qenë brengë dhe si të tilla janë diskutuar edhe në mbledhje plenare. Seanca ka kërkuar plan veprimi nga RTK-ja për adresimin e rekomandimeve të ngritura. Pas shumë insistimeve të Komisionit që RTK-ja të përmbush obligimin e dal nga Vendimi i Kuvendit, kemi pranuar planin aksional nga RTK-ja, të cilin Komisioni e ka analizuar në një mbledhje të veçantë, por e ka radhitur prapë bashkë me Raportin vjetor të RTK – së, në mënyrë që deputetët të kenë informata të plota për këtë institucion. Plani aksional nuk adreson rekomandimet e ngritura. Edhe sipas ZAP-it, rekomandimet nuk janë aderuar me planin aksional. Auditimi i RTK-së është bërë nga Audit&Conto, kompani e kontraktuar nga RTK-ja. Ky është konflikt interesi. Raporti i auditorit të pavarur është shumë sipërfaqësor, në veçanti në lidhje me pagesën e borxheve të vjetra. Kjo kompani audituese ka dhënë një opinion të kualifikuar, me theks regjistrimi i pasurisë dhe trajtimi i obligimeve të vjetra. RTK-ja nuk e din vendndodhjen e pasurisë. RTK-ja financohet drejtpërdrejt nga Kuvendi, prandaj, përgjegjësia bie mbi komisionin për të adresuar problemet saktë. Po ashtu, Komisioni nuk e ka letrën e menaxhmentit. Drejtori i RTK-së është ftuar të marr pjesë. Ata nuk i janë përgjigjur ftesës. Propozoj që Komisioni të dal me rekomandime konkrete. Nëse RTK-ja ka kërkesë për takim mund ta bëjmë, por Kuvendi është në pritje të mendimit të Komisionit. E hapi diskutimin.

Valbona Dibra - Komisioni mund ta diskutojë Raportin, por pa prezencën e menaxhmentit të RTK-së është i pakuptimtë. Duhet bërë edhe një përpjekje, që ata të jenë të pranishëm në këtë mbledhje, sepse problemet financiare të RTK-së janë të mëdha, pastaj opinionin është i kualifikuar. RTK-ja ka probleme të shumta financiare, ka borxhe të trashëguara dhe në një gjendje të vështirë, Komisioni duhet të jap kontributin e tij, në mënyrë që RTK-ja të del nga kjo gjendje. Problemet janë të trashëguara që nga viti kur është shkurtuar buxheti për RTK-në. Dibra propozoi që shqyrtimi të shtyhet për një mbledhje tjetër, në mënyrë që menaxhmenti i RTK-së të jap arsyet e veta.

Imri Ahmeti, theksoi se mospërgjigja në ftesën e Komisionit nga ana e menaxhmentit, nuk e di a është e qëllimshme apo jo? Komisioni duhet të dal me rekomandimet e tij, sepse edhe seanca është në pritje të këtij Komisioni. Raporti është përshkrues i aktiviteteve e jo raport i menaxhimit dhe kontrollin financiar, i cili na intereson neve. Sipas raportit të ZAP-it, ata nuk kanë ndërmarr masa për adresimin e rekomandimeve të mëhershme. Ka pas nevojë të madhe që menaxhmenti të jetë i pranishëm, por mohimi për t'u marr me adresimin e rekomandimeve të mëhershme lenë vend për të dyshuar. Ata nuk duan të din për aksionarin, në këtë rast për Kuvendin. Pasi që Komisioni të dal me rekomandime, nuk na duhet prezenca e menaxherëve të RTK-së. Ahmeti propozoi që Komisioni të dal me rekomandimin që të mos miratojë Raportin e RTK-së. Agjendën e Komisionit nuk mund ta përcaktojë askush. Menaxheret e RTK-së nuk kanë informuar Komisionin për pamundësinë e pjesëmarrjes në mbledhje dhe arsyet për mospjesëmarrje.

Mursel Haljilji, tha se është shumë me rëndësi se pse nuk kanë ardhur përfaqësuesit e RTK-së. Ne nuk kemi informata nëse ata do të vijën apo jo sot gjatë mbledhjes. Të gjeturat janë shumë serioze. Ka një numër të madh të problemeve që e përcjellin këtë institucion; mënyra e financimit, problemi i sistematizimit të vendeve të punës, problemi i aseteve, trajtimi i borxheve dhe shumë probleme të tjera. Përgjigjet për këto probleme mund t'i marrim vetëm nga menaxhmenti. Çka do të ndodh me të gjitha këto pyetje, interesime të Komisionit? Këto janë probleme shumë serioze? Përkrah vendimin e komisionit cilido të jetë ai, mirëpo, është shumë e rëndësishme që menaxheri i RTK-së të jetë në Komision, për t'u përgjigjur për problemet e ngritura me raport.

Afrim Hoti, pyeti pse nuk është stafi menaxhues i RTK-së, kur janë përgjegjës para Kuvendit? Me çfarë të drejte ligjore, menaxhmenti i RTK-së nuk i përgjigjet Kuvendit? Borxhet e tyre janë rritur për mbi 1 milion e 744 mijë euro. Në vitin 2012, 3 milion janë borxhet e tyre. Kujt i japin llogari ata?

Albert Kinolli, tha se raporti nuk e trajton performancën e RTK-së, plani i veprimit nuk adreson çështjet e ngritura sipas rekomandimeve si dhe mungon letra e menaxhmentit. Pa prezencën e menaxherëve të RTK-së jemi të hendikepuar, por përkrah propozimin që Komisioni të vazhdojë me shqyrtimin dhe t'i drejtohet mbledhjes plenare me rekomandime.

Valbona Dibra, theksoi se Komisioni ka dy mundësi në këtë rast: ose të vazhdojë me shqyrtimin dhe të dalë me rekomandim për Kuvendin, ose mbledhja të shtyhet për një ditë tjetër, në mënyrë që të marrim përgjigje nga menaxhmenti i RTK-së, për gjendjen në RTK. Asnjë institucion nuk mund të ndërhyjë në agjendën e Komisionit. Është shumë e rëndësishme prezenca e menaxhmentit për interesimet e Komisionit.

Ramiz Lladrovci, shprehu mendimin që Komisioni t'i rekomandojë seancës që të mos shqyrtohet raporti derisa të kemi një përgjigje nga menaxhmenti i RTK-së. Komisioni mund të rekomandojë edhe bllokimin e buxhetit për RTK-n, sepse ata nuk japin raport. Bashkë me ftesën duhet të njoftohet menaxhmenti i RTK-së në mbledhjen e radhës edhe pa prezencën e menaxherëve të RTK-së, do të shqyrtohet raporti dhe Komisioni do të dalë me rekomandime konkrete.

Adem Grabovci, theksoi se drejtori i RTK-së duhet të jetë këtu, për të dhënë sqarimet e nevojshme. Insistoj që drejtori i RTK duhet t'i përgjigjet ftesës së Komisionit. Komisioni duhet të kërkojë sqarim për mospraninë e drejtorit të RTK-së në mbledhje të Komisionit. Çdo institucion është përgjegjës para këtij Komisioni, përdërisa financohet nga buxheti i shtetit. Nëse ka arsytim për mospjesëmarrje në mbledhje, atëherë arsyetimi është dashur të behet me kohë. Mosarsyetimi për mungesë, është injorim i Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- Shqyrtimi i raportit të RTK-së, shtyhet për datën 15 korrik 2013, në orën 11:00.

- Në mbledhjen e planifikuar për datën 15 korrik 2013, Komisioni do të shqyrtojë Raportin Vjetor të RTK-së edhe në rast se të ftuarit e këtij institucioni nuk do t'i përgjigjen ftesës së Komisionit.

4. Të ndryshme

Kryetari, njoftoi anëtarët e Komisionit me kërkesën e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, që shqyrtimi i Raportit të Auditimit të MKK-së, të bëhet në një mbledhje tjetër, për shkak të pamundësisë së ministrit që të marr pjesë në mbledhjen e datës 15 korrik 2013.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Shqyrtimi i raportit të auditimit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2012, i planifikuar për datën 15 korrik 2013, në orën 11:00, shtyhet për kohë të pacaktuar.

Mbledhja përfundoi në orën 9:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu